




NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.




Auditimi i Pasqyrave Financiare nga Auditori i Jashtëm

Vendimi nr: V

Miratohet Auditimi i Pasqyrave Financiare nga Auditori i Jashtëm për vitin 2019.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi	Kryesuesi i BD
Nënshkrimi	Berat Lushtaku	Bytyqi
Data: 24.06.2020	<i>Berat Lushtaku</i>	<i>Bytyqi</i>



N.H IBËR LEPENC SH.A
Pasqyrat financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

Përmbajtja:

Faqe:

Raporti i Auditorit të Pavarur	2
Pasqyra e pozitës financiare	8
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	9
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	10
Pasqyra e rrjedhës së parasë	11
Shënimet e pasqyrave financiare	12



Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala
10000 Prishtina
Republic of Kosovo

T +383 38 247 771
T +383 38 247 801
F +383 38 247 801
www.grantthornton-ks.com

Për pronarin dhe menaxhmentin e NFI Iber Lepenc Sh.A.

Opinion i Kualifikuar

Në kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të NFI Iber Lepenc Sh.A. (referuar më tej si “Kompania”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç efektit të çështjeve të përshkruara në *Baza për Opinion të Kualifikuar* pjesë e raportit tonë, pasqyrat shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2019 dhe performancën e saj financiare si dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të Kualifikuar

1. Siç shpaloset në Shënimin 6 të pasqyrave financiare shoqëruese, vlera neto kontabël e pronës, impianteve dhe pajisjeve të Kompanisë më 31 Dhjetor 2019 arrin në 109,963,250 euro (2018: 113,333,055 euro). Një pjesë e pronave, impianteve dhe pajisjeve, siç shpaloset në politikën e kontabilitetit në shënimin 4(a) të pasqyrave financiare shoqëruese, të cilat janë përvetësuar deri më 1 janar 2007 dhe ekzistuese në datën e raportimit, mbahen në rivlerësim, bazuar në vlerësimin e kryer nga vlerësues të pavarur, zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar të mëpasshëm. Të gjithë zërat e tjerë të pronave, impianteve dhe pajisjeve, të përvetësuar pas kësaj date, deklarohen me kosto zvogëluar për zhvlerësim të akumuluar. Politika e zbatueshme e kontabilitetit, e shpalosur në Shënimin e përmendur më lart dhe SNK 16: Prona, impiantë dhe pajisjet, gjithashtu, kërkojnë rivlerësim të rregullt të zërave të mbajtur në vlerësim për të siguruar që vlera e tyre neto të mos ndryshojë materialisht nga ajo që do të ishte e përcaktuar duke përdorur vlerën e drejtë në datën e raportimit. Bazuar në informacionet e vëna në dispozicion ndaj nesh, një rivlerësim i tillë nuk është bërë pas datës së vlerësimit deri më 31 dhjetor 2019.

Për më tepër, politika e zbatueshme e kontabilitetit dhe SNK 36: Dëmtimi i pasurive, i shpalosur më tej në Shënimin 4b në pasqyrat financiare shoqëruese, kërkon që pasuritë e zhvlerësueshme të rishikohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera kontabël nuk mund të rikuperohet. Bazuar në informacionet e vëna në dispozicion ndaj nesh, një rishikim i tillë nuk është bërë më 31 dhjetor 2019, pavarësisht ekzistencës së indikatorëve të caktuar për dëmtim të mundshëm të këtyre pasurive në datën e raportimit.

Prandaj, në mungesë të të dhënave dhe informacionit të mjaftueshëm të duhur, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse rregullimi i vlerës neto kontabël të pronave, impianteve dhe pajisjeve të Kompanisë është i nevojshëm në datën e raportimit. Për më tepër, një rregullim i tillë, nëse do të ishim në gjendje të kënaqim veten me vlerën neto mbartëse të pronës, impianteve dhe pajisjeve të Kompanisë, mund të ketë një efekt material domethënës mbi pozicionin financiar dhe rezultatet e operacioneve të Kompanisë më dhe për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2019.

2. Siç shpaloset në Shënimin 7 të pasqyrave financiare shoqëruese, më 31 dhjetor 2019 bilanci i të arkëtueshmeve tregtare të Kompanisë arrin në 1,509,719 euro (2018: 1,636,184 euro), neto nga provizioni i dëmtimit të lidhur me 15,408 euro (2018: njëjtë). Bazuar në të dhënat dhe informacionin e bërë të disponueshëm ndaj nesh, ne kemi identifikuar se më 31 dhjetor 2019, Kompania nuk ka vlerësuar as nuk ka njohur humbje shtesë nga dëmtimi në të arkëtueshmet tregtare të saj për shkak të mos arkëtimit të tyre. Politika e zbatueshme e kontabilitetit, e shpalosur në Shënimet 4 (d) dhe (f) për pasqyrat financiare shoqëruese dhe SNRF 9: Instrumentet Financiare, gjithashtu, kërkon që Kompania të vlerësojë provizion të humbjeve bazuar në vjetërsinë e bilancit të llogarive të arkëtueshme dhe përvojën historike të shlyerjes, vlefshmërinë kreditorë të klientit dhe ndryshimet në kushtet e pagesës së klientit.

Bazuar në sa më sipër, në mungesë të të dhënave dhe informacionit të mjaftueshëm të duhur, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse rregullimi në vlerën kontabël neto të të arkëtueshmeve tregtare të kompanisë është i nevojshëm në datën e raportimit. Për më tepër, një rregullim i tillë, nëse do të ishim në gjendje të kënaqim veten me vlerën kontabël neto të të arkëtueshmeve tregtare të Kompanisë, mund të ketë një efekt material domethënës mbi pozicionin financiar dhe rezultatet e operacioneve të Kompanisë më dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare në raportin tonë. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës së Kontabilistëve për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësinë tonë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se provat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, kishin më shumë rëndësi në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u trajtuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë mbi të, dhe ne nuk japim një opinion të veçantë për këto çështje.

Çështja kryesore e Auditimit

Rreziku i mashtrimit në njohjen e të hyrave

SNA supozon se ekziston rreziku i mashtrimit në njohjen e të hyrave në çdo angazhim të auditimit. Ne jemi përqendruar në njohjen e të hyrave sepse ekziston rreziku i mbivlerësimit të qëllimshëm të të hyrave nga menaxhmenti për të përmbushur objektivin e shitjeve dhe për të siguruar stimulimet nga performanca. Për më tepër, ekziston rreziku që Kompania mund të mos ketë regjistruar transaksione të të hyrave siç duhet në lidhje me kthimet dhe zbritjet e shitjeve në fund të vitit. Politikat e kontabilitetit, gjykimet dhe vlerësimet e lidhura janë shpalosur në Shënimin 3 në pasqyrat financiare shoqëruese.

Rreziku i tejkalimit të menaxhimit të kontrolleve të brendshme

Bazuar në SNA dhe metodologjinë tonë të auditimit, tejkalimi i menaxhimit të kontrolleve duhet të konsiderohet si një rrezik i rëndësishëm për çdo angazhim të auditimit. Menaxhmenti mund të manipulojë në mënyrë direkte ose indirekte të dhënat e kontabilitetit dhe të përgatisë pasqyra mashtruese financiare duke kontrolluar paragjykimet që përndryshe funksionojnë në mënyrë efektive.

Theksim i çështjes

Siç është shpalosur në Shënimin 2 (j), pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur duke supozuar se Kompania do të vazhdojë të përmbush hipotezën e vijmësisë. Kompania raportoi fitim para interesit, tatimit dhe zhvletësimin për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019 në shumën 857,913 euro dhe humbje neto për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019 në shumën 3,753,050 euro dhe nga ajo datë humbjet e akumuluarat të Kompanisë janë në shumën 49,255,874 euro. Këto kushte tregojnë një pasiguri materiale, e cila mund të hedh dyshime të mëdha në aftësinë e Kompanisë për të përmbushur hipotezën e vijmësisë. Aftësia e kompanisë për të vazhduar ta përmbushur hipotezën e vijmësisë varet nga realizimi i objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Planin tre vjeçar të Biznesit të Kompanisë 2018 - 2021.

Menaxhmenti beson se po merr të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e biznesit të Kompanisë në rrethanat aktuale. Menaxhmenti nuk ka qëllim ose nevojë të

Si u trajtua çështja në auditimin tonë

Ne vlerësuam konsistencën e zbatimit të politikës së njohjes së të hyrave duke rishikuar politikën e kontabilitetit për burimet e ndryshme të të hyrave të Kompanisë. Ne testuam hartimin dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve mbi sistemet e të hyrave për të përcaktuar shtrirjen e testeve thelbësore shtesë që kërkohet. Ne nuk kemi gjetur keqdeklarime materiale nga testimi ynë. Ne kontrollouam se të ardhurat ishin njohur në kohën e duhur duke testuar një mostër të transaksioneve dhe duke krahasuar datat e faturimit, kundër të cilave të ardhurat ishin njohur. Asnjë përjashtim nuk u vërejt nga testimi ynë.

Ne testuam përshtatshmërinë e hyrjeve në ditar të regjistruara në librin kryesor duke u bërë pyetje individëve të përfshirë në procesin e raportimit financiar në lidhje me aktivitetin e papërshtatshëm dhe të pazakontë dhe hyrjet e testuara të ditarit. Ne kemi konsideruar nëse ka ndonjë dëshmi të gjykimit nga ana e Menaxhmentit në vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme të kontabilitetit të rëndësishme për pasqyrat financiare. Ne gjithashtu vlerësuam mjedisin e përgjithshëm të kontrollit të Kompanisë dhe intervistuam menaxhmentin e lartë.

nuk përfshijnë ndonjë rregullim dhe riklasifikim që do të ishte i nevojshëm në rast se ky supozim nuk do të ishte i vlefshëm.

Opinionin ynë nuk është modifikuar për shkak të çështjes së mësipërme.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të NH Ibër Lepenc Sh.A. më dhe për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2018 janë audituar nga një auditor tjetër, raporti i të cilit, i datës 19 Prill 2019 ka shprehur opinion të modifikuar në lidhje me vlerën neto kontabël të pronave, impianteve dhe pajisjeve, si dhe vlerën kontabël neto të arkëtueshmeve tregtare më 31 Dhjetor 2018.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për kontrollin e brendshëm që përcaktohet nga menaxhmenti e që është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që të jenë pa ndonjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e hipotezës së vijimësisë së kompanisë, shpalosjet, çështjet e ndërlidhura me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë në kontabilitet përpos nëse Menaxhmenti dëshiron të likuideojë kompaninë, ndërprejë operacionet ose nuk ka alternativë reale përpos ta bëjë këtë veprim.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit, bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidencë auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Risku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollin e brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve

- Nxjerrim përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të menaxhmentit për parimin vazhdimësisë në kontabilitet bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale që lidhet me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të përmbushur parimin e vijimësisë. Nëse nxjerrim përfundim se ekziston një pasiguri materiale, na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto dhënie informacionesh shpjeguese janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të fituara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së funksionuari.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Raport për kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

1. Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Menaxhmentit për operacionet e Kompanisë për vitin 2019 në përputhje me nenin 7 të Ligjit Nr.06-L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Përgjegjësia jonë, e thënë në nenin 10 të Ligjit, është të shprehim një opinion në lidhje me pajtueshmërinë me rregulloret dhe konsistencën e Raportit të Menaxhmentit me pasqyrat financiare të audituara të Kompanisë, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019.

Sipas opinionit tonë, Raporti i Menaxhmentit për operacionet e Kompanisë për vitin 2019:



- është në përputhje me pasqyrat financiare të audituara të Kompanisë për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2019, dhe
 - është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi (neni 7 i ligjit nr.06-L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin)
2. Për më tepër, ne deklarojmë se:
 - ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-audituese të referuara në nenin 5 të UA nr.02/2019 dhe jemi të pavarur nga entiteti i audituar gjatë auditimit, dhe

Ne nuk kemi kryer ndonjë shërbim tjetër përveç auditimit ligjor mbi pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2019.

Grant Thornton LLC

Prishtinë,

17 Prill 2020



Marjan Andonov
Auditor ligjor

NH IBËR LEPENC SH.A.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumatat në Euro)

NH IBËR LEPENC SH.A.


PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR


(Vlerat e shprehura në euro)

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	Shënim	2019	2018
PASURITË			
Pasuritë afatgjata			
Prona, impiantet dhe pajisjet	6	109,963,250	113,333,055
Investimet nën projektin "Sigurimi i ujit dhe mbrojtja e kanalit"	6.1	195,056	70,244
Gjithsej (I)		110,158,306	113,403,299
Pasuritë afatshkurta			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	1,509,719	1,636,184
Parapagimet dhe kërkesat tjera	8	146,794	22,060
Stoqet	9	1,167,545	1,207,288
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	10	2,969,764	2,266,558
Gjithsej (II)		5,793,822	5,131,090
GJITHSEJ PASURITË (I+II)		115,952,128	118,534,389
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	11	25,000	25,000
Rezerva e rivlerësimit (Humbjet) e akumuluar		162,424,909	162,424,909
		(49,255,874)	(45,502,824)
Gjithsej		113,194,035	116,947,086
Detyrimet afatgjata			
Huamarrjet	12	500,000	500,000
Të hyrat e shtyra	13 / 13.1	1,491,433	481,418
Gjithsej		1,991,433	981,418
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	14 / 14.1	727,802	538,554
Talimet e pagueshme	15	16,128	38,031
Detyrimet ndaj personelit	16	22,730	29,301
Gjithsej		766,660	605,886
EKUITETI DHE DETYRIMET		115,952,128	118,534,389

Këto pasqyra financiare janë përdorur për publikim më 16 mars 2020 nga Menaxhmenti i Kompanisë dhe janë nënshkruar dhe emëruar nga:


Kryeshef Ekzekutiv
Berat Lushtaku


Kontabilist i Certifikuar
Kadri Sadiku




U.D. Zyrtar Kryesor Financiar
Sheremet Smakolli

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NH IBËR LEPENC SH.A.**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019
(Të gjitha shumat në Euro)

N.H IBËR LEPENC SH.A

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
(Vlerat e shprehura në euro)

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor		2019	2018
	<i>Note</i>		
Të hyrat nga aktivitetet	17	5,144,278	5,251,304
Të hyrat tjera	17.1	242,015	34,544
Gjithsej		5,386,293	5,285,848
Shpenzimet e zhvlerësimit	6 / 6.1	4,610,963	4,604,028
Shpenzimet e personelit	18	3,208,351	2,840,789
Shpenzimet administrative	19	333,480	158,455
Shpenzimet operative	20	759,061	405,158
Shpenzimet e taksave	21	227,488	222,308
Gjithsej		9,139,343	8,230,738
(Humbja) nga operacionet		(3,753,050)	(2,944,890)
Të hyrat (dalat) financiare		-	-
Humbja para tatimit		(3,753,050)	(2,944,890)
Tatimi në fitim - 10 %		-	-
Humbja neto për vitin		(3,753,050)	(2,944,890)
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Fitim/(humbja) neto gjithëpërfshirëse e vitit		(3,753,050)	(2,944,890)
<i>Fitimi para interesit, taksave dhe zhvlerësimit</i>		857,913	1,659,138
<i>Rritja (zvogëlimi) në % nga periudha paraprake</i>		(48%)	31%

Humbja gjithëpërfshirëse e cila përcjellet nga periudhat paraprake është për shkak të zhvlerësimit të lartë gjatë viteve. Shpenzimi i zhvlerësimit paraqet një zë jo-monetar sa i përket rrjedhjeve të parasë, por që ndikon drejtëpërdrejtë në rezultatën e fundvitit.

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NH IBËR LEPENC SH.A.**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019

*(Të gjitha shumat në Euro)***N.H IBËR LEPENC SH.A****PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET***(Vlerat e shprehura në euro)*

	Kapitali aksionar	(Humbjet) e akumuluar	Rezerva e rivlerësimit	Gjithsej
Balanca më 31 dhjetor 2018	25,000	(42,557,934)	162,424,909	119,891,975
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi/(humbja) e vitit	-	(2,944,890)	-	(2,944,890)
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2018	25,000	(45,502,824)	162,424,909	116,947,085
Balanca më 1 janar 2019	25,000	(45,502,824)	162,424,909	116,947,085
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi/(humbja) e vitit	-	(3,753,050)	-	(3,753,050)
Dividenda e paguar	-	-	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2019	25,000	(49,255,874)	162,424,909	113,194,035

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NH IBËR LEPENC SH.A.

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019
(Vlerat e shprehura në euro)

N.H IBËR LEPENC SH.A

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
(Vlerat e shprehura në euro)

Për vitin që përfundon me		2019	2018
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	<i>Notes</i>		
Fitimi (humbja) neto e vitit		(3,753,050)	(2,944,890)
<i>Të rregulluara për:</i>			
Zhvlerësimi	6 / 6.1	4,610,963	4,604,028
Fitimi nga shitja e pasurive fikse		(126,576)	(18,361)
Fitimi (humbja) para interesit, tatimit dhe zhvlerësimit		731,337	1,640,777
Lëvizjet në kapitalin qarkullues			
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	7-8	1,731	47,338
(Rritja)/zvogëlimi në stoqe	9	39,743	15,460
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	15	159,774	(69,106)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)		932,585	1,634,469
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	6	(1,240,116)	(195,338)
Shitjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve	6	129,692	19,439
Investimet tjera në pronë, impiante dhe pajisje	6.1 / 12	(127,970)	(72,019)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)		(1,238,394)	(247,918)
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Të hyrat e shtyera	13 / 13.1	1,010,015	(9,347)
Huamarrjet	12	-	500,000
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)		1,010,015	490,653
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalentët e parasë (I + II + III)		704,206	1,877,204
V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	10	2,265,558	388,354
VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (IV + V)		2,969,764	2,265,558

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019
(Vlerat e shprehura në euro)

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

N.H "Ibër-Lepenc" SH.A. » është konstituar në vitin 1986 si Ndërmarrje Shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes të infrastrukturës të këtij sistemi shumë funksional. Më vonë është transformuar në Ndërmarrje Publike nga UNMIK-u. Në vitin 2007 me përfundimin e korporatizimit ndërmarrja ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore. Në vitin 2007 në "Ibër Lepenc" ka përfunduar procesi i korporatizimit me të cilin është kryer edhe procesi i vlerësimit të aseteve dhe kështu nga data 1 janar 2008 ndërmarrja është regjistruar si shoqëri aksionare me emrin NH "Ibër Lepenc" – Sh.A. Prishtinë. Në ndërkohë, me kërkesë të Njesisë për Politika dhe Monitorin të Ndërmarrjeve Publike, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74 të datës 14.07.2009 dhe Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1 të datës 30.09.2009, më 22.10.2009, janë kryer ndryshimet në statutin e ndërmarrjes sipas të cilave është shuar ish Ndërmarrja Holding dhe është sqaruar se NH "Ibër-Lepenc" SH.A. është trashëgimtare e ish-Ndërmarrjes Publike dhe ish-Ndërmarrjes Holding. Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike ndërmarrja udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve, i cili ka kompetenca ekzekutive e që njëherit është edhe zyrtari më i lartë në ndërmarrje. Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/ L-087) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë aktet më të rëndësishme të cilat e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes.

Veprimtaria kryesore e kompanisë është furnizimi me ujë të patrajtuar për qëllime të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore, për kompanitë rajonale të ujësjellësve, për shfrytëzuesit industrial dhe gjeneron energji elektrike nga hidrocentrali në Ujman.

Numri mesatar i të punësuarve për vitin 2019 është 286 (2018:274).

Selia qendrore e ndërmarrjes është në Prishtinë, Sheshi "Bill Klinton", nr.13, Kosovë.

2. BAZA E PËRGATITJES

(a) Deklaratë e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me koston historike e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në vlerën e rivlerësuar.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Valuta raportuese në evidencën e NH "Ibër-Lepenc" SH.A. dhe pasqyrat financiare është valuta Euro (€). Transaksionet në valuta tjera përveç euros nëse ka pasur janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit sipas datave të transaksioneve.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, si dhe të ardhurave dhe të shpenzimeve. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, janë shpalosur në Shënimin 4 (I)

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat e shprehura në euro)

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

(j) Hipoteza e vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi supozimin se kompania do të përmbush hipotezën e vijimësisë, e cili supozon se Kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe të përmbushë detyrimet e saj në operacionet normale të biznesit. Kompania raportoi fitim para interesit, tatimit dhe zhvlerësimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 në shumën 857,913 euro dhe humbje neto në shumën 3,753,050 euro dhe nga ajo datë humbjet e akumuluar të Kompanisë janë në shumën 49,255,874 euro. Këto kushte tregojnë një pasiguri materiale, e cila mund të hedh dyshime të mëdha në aftësinë e Kompanisë për të përmbushur hipotezën e vijimësisë.

Aftësia e kompanisë për të përmbushur hipotezën e vijimësisë varet nga realizimi i objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Planin tre vjeçar të Biznesit të Kompanisë 2018 – 2021.

Menaxhmenti beson se po merr të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e biznesit të Kompanisë në rrethanat aktuale. Menaxhmenti nuk ka qëllim ose nevojë të likuidojë ose kufizojë materialisht fushën e operacioneve të tij në të ardhmen.

Kompania ka aprovuar planin tre vjeçar 2018-2021, ku qëllimet dhe objektivat e Kompanisë u prezantuan në zgjerimin e veprimtarisë, rritjen e pasurive dhe rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve që do të siguronin rritjen e të ardhurave gjatë tre viteve të ardhshme.

Menaxhmenti konsideron se nuk ka paqartësi materiale në lidhje me vazhdimësinë e Kompanisë. Humbja e akumuluar rezulton nga shpenzimi vjetor i zhvlerësimit. Flukset e parasë janë vërejtur dhe është analizuar që flukset hyrëse / dalëse të parave janë në raportin e dëshiruar që kompania të ruajë likuiditetin e saj, pavarësisht se për sa i përket fluksit të parave, shpenzimi i zhvlerësimit është zë jo-monetar. Fitimi para zhvlerësimit, tatimit dhe intersit është zvogëluar krahasuar me periudhën e mëparshme (ulje 48%). Kompania ka përmirësuar operacionet dhe rezultatet gjatë periudave të fundit, që është dëshmi e mjaftueshme që linja e pjesëmarrjes është përmbushur nga menaxhmenti i Kompanisë.

Këto pasqyra financiare nuk përfshijnë ndonjë rregullim dhe riklasifikim që do të ishte i nevojshëm në rast se ky supozim nuk do të ishte vlefshëm.

3. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA

3.1. Adoptimi i standardeve të reja dhe të rishikuara ndërkombëtare të raportimit financiar
Ndryshimet e reja në vijim të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit:

SNRF 16 Qiratë

Në vitin aktual, Kompania ka aplikuar SNRF 16 (siç është lëshuar nga IASB në janar 2016) që është e efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019.

SNRF 16 siguron një model gjithëpërfshirës për identifikimin e marrëveshjeve të qirasë dhe trajtimin e tyre në pasqyrat financiare si për qiradhënësit ashtu edhe për qiramarrësit. SNRF 16 bëhet efektiv për periudhat e kontabilitetit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019 dhe do të shfuqizojë udhëzimin aktual të qirasë duke përfshirë KIRNF 17 'Qiratë' dhe interpretime të ndërlidhura: SNRF 4 'Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban qira', SIC 15 'Qirate Operative' dhe SIC 27 'Vlerësimi i substancës së transaksioneve në formën ligjore të një qiraje.

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat e shprehura në euro)

Qëllimi i standardit të ri është lehtësimi i krahasueshmërisë së pasqyrave financiare, paraqitja e qirave financiare dhe operative në pasqyrën e pozicionit financiar të qiramarrësit, dhe sigurimi i Informacionit përkatës për përdoruesit e pasqyrave financiare në lidhje me rreziqet që lidhen me marrëveshjet . Në kontrast me një kontabilitet të qiramarrësit, SNRF 16 siguron në thelb kërkesat e kontabilitetit të qiradhënësit në SNK 17.

Data e aplikimit fillestar të SNRF 16 për Kompaninë është 1 janari 2019.

Ndikimi në kontabilitetin e qiramarrësit

Standardi i ri ndërpret diferencimin midis qirasë operative dhe financiare në librat e qiramarrësit dhe kërkon të njohë një pasuri me të drejtë përdorimi dhe detyrimin e qirasë në lidhje me të gjitha marrëveshjet e qirasë së qiramarrësit, përveçse qirave afatshkurtra dhe qirave me vlerë të ulët të pasurisë, e cila i nënshtrohen përjashtimeve.

Me aplikimin fillestar të SNRF 16, për qiradhëniet e klasifikuara më parë si qira operative (përveç siç vërehet më poshtë), Kompania do të njohë pasurinë me të drejtë përdorimi dhe detyrimeve të qirasë në pasqyrën e pozicionit financiar / pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar. Paragrafët e mëposhtëm shpjegojnë metodat e matjes që do të zbatohen për ato qira.

Me aplikimin fillestar të SNRF 16, për secilën qira veç e veç, detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, duke u zbritur duke përdorur normën e huamarrjes inkrementale të qiramarrësit në datën e aplikimit fillestar. Për më tepër, Kompania vendosi të përdorë metodat e mëposhtme në lidhje me matjen e këtyre detyrimeve të qirasë:

- të aplikojë një normë të vetme skontuese në një portofol të qirave me karakteristika të arsyeshme të ngjashme;
- të përdor pasqyrimin, siç është përcaktimi i afatit të qirasë nëse kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Për më tepër, kur fillon matjen e pasurive me të drejtë përdorimi, Kompania:

- Do të mbështetet në vlerësimin e saj nëse qiratë janë shumë të mëdha duke zbatuar SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kontigjente dhe Pasuritë e Kontigjente menjëherë përpara datës së aplikimit fillestar, si një alternative për të kryer një rishikim të zhvlerësimit të pasurisë me të drejtë përdorimi, në një datë të aplikimit fillestar. Si pasojë, pasuria me të drejtë përdorimi të njohur në datën e aplikimit fillestar do të rregullohet nga shuma e çdo provizioni për qiratë e mëdha që njihen në pasqyrën e pozicionit financiar menjëherë përpara datës së aplikimit fillestar.
- Do të përjashtojë kostot fillestare direkte nga matja e pasurisë me të drejtë përdorimi në datën e aplikimit fillestar

Më pas, Kompania do të:

- (a) të njohë zhvlerësimin e pasurisë me të drejtë përdorimi dhe interesit mbi detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes / pasqyrës së konsoliduar të fitimit ose humbjes;
- (b) ndaj shumën totale të parave të paguara mbi kryegjënë (të paraqitur në aktivitetet e financimit) dhe interesin (të paraqitur në aktivitetet operative) në pasqyrën e rrjedhës së parasë / pasqyrën e konsoliduar të parasë.

Aplikimi i SNRF 16 nuk ka asnjë efekt në pozicionin financiar dhe performancën financiare të Kompanisë, më dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 1 Janar 2019 gjithashtu, pasi që Kompania nuk ka kontratë qiraje në ato data dhe periudha të konsideruara.

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat e shprehura në euro)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

a. Prona, Impiantet dhe Pajisjet

Zërat e pronave, impianteve dhe pajisjeve ekzistuese që nga 1 janari 2007 mbahen në rivlerësim bazuar në vlerësimin e bërë nga vlerësuesit e pavarur, zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar të mëpasshëm. Efekti i rivlerësimit merret në llogarinë e kapitalit. Të gjitha pronat, impiantet dhe pajisjet e tjera deklarohen me kosto minus zhvlerësim të akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me pasurinë do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën ato janë bërë.

Toka nuk është zhvlerësuar. Zhvlerësimi për pasuritë tjera llogaritet duke përdorur metodën e drejtëvizore për të shpërndarë koston e tyre ose shumat e rivlerësuar në vlerat e tyre të mbetura gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar, si më poshtë:

#	Përshkrimi i llojit të pasurisë	Viti 2019	Viti 2018	Ligji: Nr.03/L-113
				Admin.tatimore.
				Viti 2011
1	Objektet ndërtimore	1% - 2%	1% - 2%	5%
2	Makineritë e rënda	5% - 15%	5% - 15%	10%
3	Automjetet	5% - 20%	5% - 20%	20%
4	Pajisje të zyrës dhe kompjuterike	10% - 20%	10% - 20%	20%

Vlera e reziduale dhe jetëgjatësia e pasurive rishikohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë të bilancit. Vlera kontabël e një pasurie shënohet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se vlera e parashikuar e rikuperueshme. Fitimet dhe humbjet nga heqjet përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave

b. Dëmtimi i pasurive jo-financiare

Pasuritë që kanë një jetë të papërcaktuar të dobishme nuk i nënshtrohen amortizimit dhe testohen çdo vit për dëmtim.

Pasuritë që i nënshtrohen amortizimit shqyrtohen për dëmtim sa herë që ngjarje ose ndryshime në rrethana tregojnë se vlera kontabël nuk mund të rikuperohet. Një humbje nga dëmtimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e pasurisë tejkalon shumën e rikuperueshme të saj. Shuma e rikuperueshme është më e larta e vlerës së drejtë të një pasurisë më pak se kosto për të shitur dhe vlerën në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmtimit, pasuritë grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë flukse monetare të identifikueshme veç e veç (njësi gjeneruese të parave). Pasuritë jo-financiare që kanë pësuar dëmtim janë rishikuar për kthimin e mundshëm të dëmtimit në çdo datë raportimi.

c. Stoqet

Stoqet vlerësohen sipas koston më të ulët ose vlerës neto të realizuar, dhe raportohen jo më shumë se shuma e pritur të realizohet nga shitja ose përdorimi. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit minus koston e vlerësuar të nevojshme për ta kryer shitjen. Kur kostoja e një artikulli të stoqeve e tejkalon vlerën neto të realizueshme, ky

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat e shprehura në euro)

tejkallim do të evidentohet si humbje në pasqyrën e të ardhurave. Kostoja e stoqeve është e përcaktuar në bazë të formulës "I pari Brenda - I pari jashtë" apo FIFO që nënkupton se ndërmarrja stoqet e blera me çmimin e parë i trajton dalje të parave.

d. Instrumentet Financiare

Njohja dhe ç'regjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiarë njihen kur Kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga pasuria financiare skadojnë, ose kur pasuria financiare edhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një material të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për shpenzimet e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Pasuritë financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kostoja e amortizuar
- vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Në peridhuat e prezentuara Kompania nuk ka ndonjë pasuri të kategorizuar si FVTPL dhe FVOCI.

Klasifikimi përcaktohet nga dy:

- modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurisë financiare
- karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare që njihen në fitim ose humbje janë paraqitur brenda kostove financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjera financiare, me përjashtim të dëmtimit të të arkëtueshmeve tregtare që paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

Matia e mëposhtme e pasurive financiare

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë përcaktuar si FVTPL):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale të saj
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Zbritja është lënë jashtë ku efekti i zbritjes është jomaterial. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare shumica e të arkëtueshmeve të tjera bien në këtë kategori të instrumenteve financiare

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat e shprehura në euro)

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPPH)

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga " të mbajtura për tu arkëtuar" ose "mbajtja për tu arkëtuar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga asetet financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në FVTPL.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse (FVOCI)

Kompania llogarit pasuritë financiare në FVTPL nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi, qëllimi i të cilit është "të mbajtura për tu arkëtuar" e parave të lidhura dhe shitjes
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas ç'regjistrimit të pasurisë.

Dëmtimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditorëve - 'modelin e humbjes së pritshme të kreditorëve (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshijnë kreditë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe FVOCI, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë e kontraktuara të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe zotimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditorëve nuk është më e varur nga kompania që fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes të kreditorëve. Në vend të kësaj, kompania konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut të kreditorëve dhe matjes së humbjeve të pritshme të kreditorëve, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një ndarje midis

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga fillimi i njohjes ose që kanë rrezik të ulët të kreditorit ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kreditorit i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').
- 'Faza 3' do të mbulonte pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kreditorëve gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

NH IBËR LEPENC SH.A.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat e shprehura në euro)

e. Kompensimi i instrumenteve financiare

Pasuritë dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar ku ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar shumat e njohura dhe ekziston një qëllim për të shlyer në bazë neto ose për të realizuar pasuritë dhe për të shlyer detyrimin njëkohësisht.

f. Llogaritë e arkëtueshme

